

ILMIHAL I PËRMBLEDHUR

MËSIMI I NAMAZIT ME ILUSTRIME



SHTËPIA BOTUESE FAZILET

ILMIHAL I PËRMBLEDHUR

MËSIMI I NAMAZIT ME ILUSTRIME

Dituri të domosdoshme për të gjithë fëmijët
Muslimanë që janë duke mësuar në shkollat
fillore, të mesme ose në kurset e Kur'anit.



SHTËPIA BOTUESE
FAZILET

Bağlar Mah. Mimar Sinan Cad. No: 52 Güneşli, Bağcılar - İST.
Tel: (0212) 657 88 00 (Pbx) - Faks: (0212) 657 95 88

www.fazilet.com.tr

PARATHËNIE

Falenderimi i takon vetëm All-llâhut Teâlâ, i cili është krijues i njerëzimit dhe i të gjithë botërave.

Salati dhe Selami (Paqja dhe mëshira) e All-llâhut qofshin mbi Muhammed Mustafain (sal-lall-llahu-alejhi ve sel-lem) (i cili është dërguar si mëshira më e madhe, si shefaatçiu dhe Pejgamberi më i madh.), mbi familjen e tij, mbi shokët dhe të gjithë ata që do të ndjekin rrugën e tij deri në ditën e gjykimit.

Ilmihali, është dituria që tregon dhe shpjegon çështjet në lidhje me besimin dhe adhurimin, të cilat duhet t'i dijë çdo Musliman.

I dërguari i All-llâhut thotë: “Mësimi i diturisë është obligim (farz) për çdo Musliman dhe Muslimane”. Dituria të cilën Pejgamberi ynë (s.a.v) e ka shpjeguar me këto fjalë të çmuara, në të vërtetë është Ilmihali, i cili është i domosdoshëm për të fituar lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër (ahiretit). Për këtë arsye, çdo besimtar dhe besimtare duhet të mësojë çështjet e domosdoshme të besimit dhe të adhurimit, sepse këto çështje janë obligim (farz). Pa i mësuar dhe i besuar këto çështje të rëndësishme të cilat quhen “Domosdoshmëri fetare” njeriu nuk bëhet besimtarë i vërtetë. Ka shumë libra të vegjël dhe të mëdhenj që janë shkruar për këto tema, por megjithatë ne kemi përgatitur këtë libër që quhet “ILMIHAL” për të shpjeguar çështjet kryesore të fesë në një mënyrë sa më të lehtë dhe më të kuptueshme për çdo Musliman dhe Muslimane.

All-llâhu qoftë i kënaqur nga kjo vepër.

VËREJTJE E RËNDESISHME

Të nderuar lexues:

Në veprën që keni në dorë janë të shkruara disa sure, ajete dhe dua (lutje). Gjithashtu është paraqitur edhe leximi i tyre me anë të germave latine. Kjo për arsye që ta kenë të lehtë t'i mësojnë përmendësh edhe ata të cilët nuk i dijnë gërmat e Kur'anit. Por megjithatë me këto germa nuk është e mundur të mësohet leximi i saktë. Për këtë arsye ata të cilët i mësojnë me këto germa, duhet që ta mësojnë patjetër nga një hoxhë mënyrën e drejtë të leximit.

Kur të lexohen suret me anë të germave latine, është e domosdoshme që t'u kushtohet vëmendje shenjave të mëposhtme:

â : a e zgjatur

û : u e zgjatur

î : i e zgjatur

h : lexohet h e fortë që del nga fyti

Shkurtime:

(xh.xh) : “xhel-le xhelaluhu”

(s.a.v) : “sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem”

(a.s) : “alejhis-selam”

(r.a) : “radijallu anh”

KUJDES

Në këtë vepër që keni në dorë gjenden të shkruara shkrime të madhëruara si Ajete Kerim, Hadithe Sherif, dua etj, për këtë arsye ju tërheqim vëmendjen që të mos e hidhni në tokë dhe ta respektoni ashtu siç duhet.



FEJA E JONE

ISLAMI

FEJA

Feja: Është një ligj hyjnor me anë të të cilit njerëzit me dëshirën dhe vullnetin e tyre gjejnë lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër.

All-Ilâhu Teâlâ, duke filluar që nga njeriu i parë Ademi (alejhis-selam), me anë të pejgamberëve i ka bërë të ditur njerëzve fenë, e cila që në thelbin e saj është Islami. All-Ilâhu Teâlâ fenë tonë Islamit e ka plotësuar me anë të të Dërguarit të tij Muhammed Mustafa (sal-lall-Ilahu-alejhi ve sel-lem). Personi i cili beson në fenë Islame quhet Musliman. Edhe ne jemi Muslimanë elhamdulillah.

SHERIATI (kushtetuta Islame)

Sheriat quhet feja, por gjithashtu sheriat quhen të gjitha ibadetet, veprimet dhe rregullat e fesë. Pra sheriat është feja dhe feja është sheriat.

BESIMI

Besimi është pranimi dhe vërtetimi me zemër i të gjithë urdhërave të All-llâhut Teâlâ të cilat na i ka përcjellë me anë të Pejgamberit tonë (s.a.v).

Besimi plotësohet me anë të këtij vërtetimi që bëhet me zemër. Por që një person të quhet Musliman dhe të gëzojë të gjitha të drejtat e Muslimanit duhet që gjatë jetës së tij ta thotë me gojë dhe ta vërtetojë me zemër shehadetin.

Kushtet e besimit janë gjashtë. Këto kushte janë renditur më poshtë në fillim arabisht dhe më pas shpjegimi i tyre në gjuhën shqipe.

أَمِنْتُ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ
الْآخِرِ وَبِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ مِنَ اللَّهِ تَعَالَى
وَالْبَعْثِ بَعْدَ الْمَوْتِ حَقٌّ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ
إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

Âmentu bil-lâhi ve melâiketihî ve kutubihî ve rrusulihî ve'l jevnil âhîri ve bil-kaderi hajrihi ve sher-rihi mine'll-llâhi Teâlâ ve'l ba'thu ba'de'lmevti hak-kun **Eshhedu el lâ ilâhe il-lall-llâh ve eshedu enne Muhammeden abduhû ve rrasûluhu.**

Kuptimi: Unë i kam besuar All-llâhut (xh.xh), melëkve (engjëjve) të tij, librave të tij, të dërguarve të tij, ditës së ahiretit, kam besuar kaderin, se e mira dhe e keqja janë krijuar prej tij (caktimit të tij). Ringjallja pas vdekjes është hak. Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llâhut Teâlâ dhe se Muhammedi (s.a.v) është i dërguari i tij.